



EKIPI I TRAJTIMIT

MJEKU I KUJDESIT PARËSOR (PRIMARY CARE PHYSICIAN, PCP) OSE OFRUESI I KUJDESIT (NDIHMËSMJEKU OSE INFIERMIER ME KUALIFIKIM TË AVANCUAR)

- Pika e parë e kontaktit për simptomat
- Mund të mos marrë në konsideratë praninë e kancerit të vezores
- “Portë” për çdo specialist, siç është onkologu gjinekologjik
- Shihni listën e kontrollit për pacientët për një listë gjithëpërfshirëse të veprimeve dhe detyrave të sugjeruara për PCP/ObGyn.
- Duhet të bëjë referim në onkologjinë gjinekologjike
- Pacienti duhet të ndiqet nga mjeku i kujdesit parësor gjatë dhe pas trajtimit të kancerit

MJEKU OBSTETËR-GJINEKOLOG (OBSTETRICIAN-GYNECOLOGIST, OBGYN)

- Është i specializuar për shëndetin e grave
- Mund të jetë pika e parë e kontaktit për simptomat
- Duhet të marrë në konsideratë kancerin e vezores
- “Portë” për çdo specialist, siç është onkologu gjinekologjik
- Shihni listën e kontrollit për pacientët për një listë gjithëpërfshirëse të veprimeve dhe detyrave të sugjeruara për PCP/ObGyn.
- Duhet të bëjë referim në onkologjinë gjinekologjike
- Pacienti duhet të ndiqet nga Ob/Gyn gjatë dhe pas trajtimit të kancerit

ONKOLOGU GJINEKOLOG (GYNECOLOGIC ONCOLOGIST, GYO)

- Mjeku i duhur për kujdesin e pacientëve me kancer gjinekologjik, përfshirë atë të vezores
- Shihni listën e kontrollit për pacientët për një listë gjithëpërfshirëse të veprimeve dhe detyrave të sugjeruara për GYO

ONKOLOGU I RREZATIMIT

- Mjek i specializuar në planifikimin, administrimin e rrezatimit dhe kujdesin e pacientëve që marrin rrezatim ose forma të tjera energjie për të vrrarë kancerin

PATOLOGU

- Mjek i specializuar në diagnostikimin e sëmundjes (kancerit) duke u bazuar në ekzaminimin e organeve ose indeve.

NDIHMËSMJEKU (PHYSICIAN ASSISTANT, PA) OSE INFIERMIERI I SPECIALIZUAR (NURSE PRACTITIONER, NP)

- Një profesionist i licencuar, i specializuar në një fushë të veçantë, që punon me një mjek
- Kompetenca për të bërë rekomandim varion sipas rolit dhe shtetit

SPECIALIZANTI

- Një mjek që ka përfunduar një program trajnimi pas shkollës së mjekësisë dhe dëshiron të specializohet për kancerin; specializimi zgjat 2-4 vjet, në varësi të programit
- Punon nën drejtimin e një mjeku me përvojë
- Mbikëqyr mjekët e rinj

PRAKTIKANTI

- Një i diplomuar nga shkolla e mjekësisë që ka hyrë në një program trajnimi; trajnimi zgjat 1-5 vjet, në varësi të programit dhe specialitetit
- Punon nën mbikëqyrjen e praktikantëve dhe mjekëve me përvojë

INFIERMIERI (OCN, RN)

- Një infermier i regjistruar që është certifikuar në fushën e kancerit dhe që punon me një mjek
- Ricertifikohet çdo dhjetë vjet, ngjashëm me onkologjinë mjekësore

FARMACISTI (PHARM, BCOP)

- Profesionist me doktoratë në farmaci dhe i certifikuar nga bordi
- Ka kryer 2-4 vjet trajnim shtesë në fushën e farmacisë specifike për kancerin
- Ricertifikohet çdo dhjetë vjet, ngjashëm me onkologjinë mjekësore

PUNONJËSI SOCIAL (OSW-C)

- Profesionist i përgatitur, i cili ka përfunduar studimet master dhe ka punuar veçanërisht në fushën e kancerit, kujdesit paliativ dhe/ose kujdesin në fund të jetës